



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 73 regjistër (JR)  
Datë 24.11.2021

Nr. 13 i vendimit  
Datë 17.02.2025

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 17.02.2025, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Jerina Gjika, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 73/2021 (JR), datë 24.11.2021, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Izet Dushaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 451, datë 23.09.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Izet Dushaj.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 51/1, gjerat “a”, “b”, “c” dhe 54, germa “d” e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit Izet Dushaj, të paraqitura në ankim dhe në parashtrimet me shkrim të depozituara në Kolegji, i cili kërkoi përfundimisht prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 451, datë 23.09.2021, dhe urdhërimin e këtij të fundit për vazhdimin e hetimit administrativ për tri kriteret e procesit të rivlerësimit që lidhen me pasurinë, figurën dhe aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Izet Dushaj, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), brenda afatit ligjor<sup>1</sup>, në përputhje me nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë<sup>2</sup>.
3. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>3</sup>, duke konstatuar se:
  - (i) Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin.
  - (ii) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
  - (iii) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.
  - (iv) Nuk ka kryer deklaram të rremë.
  - (v) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Bazuar në nenin 4, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor<sup>4</sup>, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Izet Dushaj, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë.

<sup>1</sup> Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

<sup>2</sup> Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 25.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së nr. {\*\*\*} prot., datë 25.01.2017. Të njëjtën datë mban edhe deklaratat e pasurisë në rubrikën përkatëse.

<sup>3</sup> Dërguar me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.05.2018.

<sup>4</sup> Shih paragrafin 9 e vijues, në faqet 2 dhe 3 të vendimit të Komisionit nr. 451, datë 23.09.2021.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 451, datë 23.09.2021, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Izet Dushaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës [...]”.
6. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve për kriterin e vlerësimit të pasurisë, si më poshtë.
  - *Lidhur me pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 158 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pagesën e çmimit për blerjen e tij.*
  - *Lidhur me automjetin e markës “Audi”, blerë në maj të vitit 2012, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pagesën e çmimit për blerjen e tij.*
  - *Lidhur me përdorimin e automjetit të markës “Volkswagen Passat”, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën “vetting”, nuk ka deklaruar në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, ndaj ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë në përdorim.*
  - *Referuar analizës financiare, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara për vitet 2005, 2007, 2009, 2010, 2012, 2013 dhe 2014, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*
  - *Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

## III. Shkaqet e ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 451, datë 23.09.2021, duke e kundërshtuar atë si vendim të njëanshëm, të pabazuar në fakte dhe në ligj dhe rezultat i zbatimit të gabuar të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se me këtë vendimmarrje, atij i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, si pasojë e cenimit nga ana e Komisionit: (i) të parimit të arsyetimit të vendimit; (ii) të parimit të aksesit; (iii) të parimeve të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve; (iv) të parimit të prezumimit të pafajësisë; (v) të parimeve të pavarësisë dhe paanësisë; (vi) të parimit të ligjshmërisë; (vii) të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit; dhe (viii) të parimit për mungesë të fuqisë prapavepruese të ligjit.
8. Bazuar në nenet 63, pika 1, 65 dhe 66, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenet 51, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” dhe 54, shkronja “d” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe, në përfundim të gjyqimit, të vendosë:
  - *Prishjen e vendimit nr. 451, datë 23.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
  - *Urdhërimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për vazhdimin e hetimit administrativ për tre komponentët e procesit të rivlerësimit që lidhen me pasurinë, figurën dhe aftësinë*

*profesionale të subjektit të rivlerësimit Izet Dushaj, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.*

9. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale të procesit të zhvilluar në Komision, parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

*9.1. Vendimi i Komisionit për të mos pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe vlerësimin e tij në bazë të tri kritereve, përbën vendimmarrje të paragjykuar, në shkelje flagrante të ligjit dhe të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.*

*9.2. Komisioni ka shkelur të drejtën e subjektit të rivlerësimit për mbrojtje efektive gjatë seancës dëgjimore, garantuar nga neni 35 i Kodit të Procedurave Administrative, si dhe neni 6, pika 1 e KEDNj-së, duke qenë se ka penguar përfaqësuesin e tij ligjor për t'iu përgjigjur pyetjes së relatores së çështjes dhe duke kërkuar që kësaj pyetjeje t'i përgjigjej vetë subjekti i rivlerësimit. Mosrespektimi i së drejtës për t'u dëgjuar ka cenuar rëndë edhe parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në proces, si dhe parimin e ligjshmërisë.*

*9.3. Vendimmarrja e Komisionit lidhur me dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, është në kundërshtim me parashikimet e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se, sipas subjektit të rivlerësimit, ai nuk ndodhej as në kushtet e deklaramit të dyfishit të pasurisë së ligjshme referuar parashikimit të nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe as në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për figurën dhe pasurinë sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

10. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

i. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 158 m<sup>2</sup>, të porositur në vitin 2007 në vlerën 60.000 euro, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}” (ish-rruga “{\*\*\*}”), Tiranë:

*10.1. Konkluzioni i Komisionit për pasqyrimin e blerjes së apartamentit në vitin 2007, është konkluzion i gabuar, nuk bazohet në fakte dhe nuk i përgjigjet realitetit.*

*10.2. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka pasur për qëllim fshehjen e kësaj pasurie, është konkluzion i gabuar, alogjik, paragjykues dhe shtrembërim i qëllimshëm i fakteve dhe rrethanave.*

*10.3. Konkluzioni i Komisionit lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të banimit në Bajram Curri, si të krijuara nga një veprim i simuluar, me qëllim në dukje justifikimin e burimit të të ardhurave për pagesën e deklaruar nga subjekti për shlyerjen e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, është i gabuar.*

*10.4. Konkluzioni i Komisionit lidhur me vlerësimin e të ardhurave të deklaruara si burim për blerjen e apartamentit, është i pabazuar.*

ii. Lidhur me pasuritë e luajtshme të llojit automjet të tipit “Audi A6”, e blerë në vitin 2012 në vlerën e 5.000 eurove:

*10.5. Konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në vitin 2012, është i gabuar, në kundërshtim me ligjin dhe rezultat i një hetimi të cunguar.*

iii. Lidhur me përdorimin e sendit të luajtshëm të llojit automjet, të tipit “Volkswagen 3C Passat”, me targë {\*\*\*} dhe në pronësi të shtetasit F. B.:

*10.6. Konkluzioni i Komisionit për shkelje të detyrimit të deklarimit të këtij mjeti, është i gabuar pasi subjekti nuk ka pasur detyrim për deklarimin e këtij fakti duke qenë se përdorimi i mjetit nuk ka qenë i përhershëm, por sporadik, në raste të veçanta dhe jo pa ndërprerje.*

iv. Lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2003-2016:

*10.7. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar rezultatin e analizës financiare për periudhën e vlerësimit, si pasojë e përllogaritjes në mënyrë të gabuar të disa prej zërave të kësaj analize.*

#### **IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin kalimtar të subjektit Izet Dushaj, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

12. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>5</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të

<sup>5</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 451, datë 23.09.2021, për rivlerësimin e subjektit Izet Dushaj, i është njoftuar këtij të fundit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.10.2021, konfirmuar marrja dijëni më datë 02.11.2021, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision më datë 09.11.2021, që rezulton të jetë dita e 7 nga data e marrjes dijëni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit.

Komisionit nr. 451, datë 23.09.2021, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

14. Në përfundim, trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë procesit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Në referencë të dispozitës së sipërcituar, trupi gjykues çmoi gjithashtu se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit nuk është i nevojshëm dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

*B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni*

15. *Subjekti i rivlerësimit pretendoi se përfundimi i hetimit administrativ nga ana e Komisionit, bazuar vetëm në një kriter, si dhe vendimi në vijim për të mos pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe vlerësimin e tij në bazë të tri kriterëve, përbën shkelje flagrante të ligjit, referuar këtu nenit 4 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, edhe së drejtës së subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, referuar parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.*
16. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se parashikimi në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit *vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve [...]*, i referohet vendimmarrjes përfundimtare të Komisionit dhe jo kryerjes së procesit. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimmarrja e Komisionit për mbylljen e hetimit bazuar vetëm në një kriter vlerësimi, tregon për vendimmarrje të paracaktuar, të paravendosur, në kundërshtim me parashikimet e ligjit dhe Kushtetutës, dhe se seanca dëgjimore ka qenë thjesht një akt formal, për sa kohë nga ana e relatores, gjatë kësaj seance, nuk i është relatuar asnjë fakt, provë apo argument i paraqitur në shpjegimet me shkrim të datës 17.09.2021. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka shkelur përcaktimin e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, edhe në drejtim të mospasqyrimin në vendimin e tij të vlerësimit për dy kriteret e tjera, përveç atij të pasurisë, edhe pse ligji shprehet se vendimi merret në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, edhe kur bazohet në një kriter.
17. Subjekti pretendoi për më tepër se njoftimi i kryer nga ana e Komisionit, se vendimmarrja do të jetë e bazuar vetëm në një kriter, ka pasur ndikim psikologjik në përgatitjen e përgjigjeve dhe mbrojtjes së tij, pasi ai është përgjigjur me idenë që vendimmarrja ka qenë e paracaktuar. Vendimmarrja e Komisionit e bazuar vetëm në një kriter, sipas subjektit të rivlerësimit, ka vënë në pikëpyetje edhe paanësinë e Komisionit në këtë proces, pasi kjo vendimmarrje bie ndesh me frymën e ligjit dhe të Kushtetutës, e cila kërkon që rivlerësimi të bëhet mbi bazën e të tria kriterëve.
18. Subjekti i rivlerësimit parashitroi gjithashtu se, ndonëse nga ana e Komisionit është pretenduar se është filluar një procedurë hetimi e gjithanshme për të tria kriteret, dhe se lidhur me këtë fakt janë administruar edhe raportet e DSIK-së dhe KLD-së, këto akte nuk i janë vënë në dispozicion

subjektit, pavarësisht kërkesës së tij për t'u njohur me to, duke cenuar në këtë mënyrë, sipas tij, parimin e aksesit në dokumentacionin e dosjes së administruar nga ana e Komisionit.

19. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi procedurat e ndjekura në Komision, si dhe aktet e administruara në fashikullin e këtij të fundit lidhur me zhvillimin e procesit të rivlerësimit të subjektit Izet Dushaj, konstatoi si më poshtë.

19.1. Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur shpjegimeve të tij ndaj rezultateve të hetimit, më datë 16.09.2021, ka dorëzuar pranë Komisionit edhe një kërkesë me objekt "Riçelja e hetimit administrativ duke vlerësuar edhe dy kriteret e tjera sipas përcaktimeve të Kushtetutës dhe ligjit". Referuar përmbajtjes së kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur para Komisionit kundërshtimin e tij lidhur me vendimin e Komisionit për mbylljen e hetimit administrativ, bazuar vetëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, duke paraqitur edhe në Kolegj të njëjtat argumente si parashtruar në shkakun e ankimit objekt shqyrtimi.

19.2. Komisioni, pasi ka shqyrtuar këtë kërkesë të subjektit të rivlerësimit, me vendimin nr. 3, datë 17.09.2021, ka vendosur *refuzimin e kërkesës për riçeljen e hetimit administrativ dhe vlerësimin edhe për dy kriteret e tjera*, si dhe vijimin e procesit me seancën dëgjimore e cila, po në këtë datë, me anë të vendimit nr. 4 të trupit gjykues u caktua për t'u zhvilluar më datë 21.09.2021. Në pjesën arsyetuese të vendimit për refuzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për riçeljen e hetimit dhe vlerësimin edhe të dy kriterëve të tjera, të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni ka arsyetuar: *[...] trupi gjykues çmon se deri në këtë fazë të hetimit, provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë, sipas parashikimit të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Nëse me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, si dhe me shpjegimet dhe provat të cilat mund të paraqiten gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, do të provohet e kundërta e këtyre rezultateve, trupi gjykues, pasi t'i vlerësojë ato, do të vendosë lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit.*

20. Në analizë të sa më sipër konstatuar, ku nuk evidentohet asnjë element paragjykues në sjelljen e Komisionit ndaj procesit të rivlerësimit të subjektit Izet Dushaj, në konsideratë edhe të jurisprudencës tashmë të konsoliduar të Kolegjit<sup>6</sup> lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngjashme, trupi gjykues arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vendimmarrja e Komisionit mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit vetëm për një kriter, si dhe refuzimi prej tij i kërkesës për riçelje të hetimit dhe rivlerësimit edhe të dy kriterëve të tjera, përbën vendimmarrje të paragjykuar, në shkelje flagrante të ligjit dhe në cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, është një pretendim i pabazuar në fakte dhe në ligj.
21. Kjo vendimmarrje e Kolegjit, referuar jurisprudencës së cituar, është bazuar në parashikimin e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit Komisioni merr vendim bazuar në një ose disa prej kriterëve të rivlerësimit. Kjo dispozitë ligjore, e vlerësuar në harmoni me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit Komisioni u kalon barrën e provës subjekteve të rivlerësimit në momentin që ai arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, bën që vendimmarrja e Komisionit në këto raste, bazuar mbi parashikimet e mësipërme ligjore, të mos jetë as paragjykuese dhe as e paracaktuar.

<sup>6</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 7/2020 (JR), nr. 14/2021 (JR), nr. 34/2021 (JR), nr. 33/2022 (JR), nr. 40/2022 (JR) etj.

22. Gjithashtu, edhe pretendimi i subjektit se njoftimi i kryer nga ana e Komisionit, se vendimmarrja do të jetë e bazuar vetëm në një kriter, ka pasur ndikim psikologjik në përgatitjen e përgjigjeve dhe mbrojtjes së tij, duke qenë se ai është përgjigjur duke ditur që vendimmarrja ka qenë e paracaktuar, vlerësohet po ashtu si një pretendim i pabazuar në fakte, pasi nuk rezultoi asnjë vendim i Komisionit, i cili të ketë njoftuar subjektin e rivlerësimit se vendimmarrja do të jetë vetëm për një kriter vlerësimi. Vendimi nr. 2, datë 28.07.2021, i Komisionit, i cili i është njoftuar subjektit të rivlerësimit, ka pasur për objekt njoftimin e përfundimit të hetimit administrativ vetëm për njërin prej kritereve, duke mos u shprehur mbi ndërprerjen e procedurës së hetimit për dy kriteret e tjera. Në këtë kuptim, çmohet i paprovuar dhe i pajustificuar pretendimi i subjektit për ndikim të shtuar psikologjik në përgatitjen e përgjigjeve lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, mbi gjetjet për vetëm njërin kriter, krahasuar me ndikimin që do të kishte në çdo rast përgatitja e përgjigjeve për të njëjtat gjetje, në rastin që hetimi do të kishte përfunduar për të tria kriteret e vlerësimit.
23. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se atij i është cenuar aksesit në dosjen e hetimit administrativ, duke mos iu vënë në dispozicion aktet e administruara gjatë hetimit administrativ lidhur me dy kriteret e rivlerësimit, kriterit të kontrollit të figurës dhe atij të vlerësimit të aftësive profesionale, për të cilat hetimi ishte ende në proces, trupi gjykues vlerëson se, në kushtet kur procedura e kryer në Komision dhe për të cilën Komisioni ka arritur në vendimmarrjen objekt ankimi nuk është bazuar në këto akte, dhe se lidhur me to nuk është evidentuar asnjë gjetje e cila të jetë vlerësuar me ndikim në këtë vendimmarrje, rast për të cilin do të vlerësohej e mohuar e drejta e aksesit, pretendimi i subjektit çmohet se nuk paraqet relevancë në drejtim të shkaqeve ligjore që mund të cenojnë vendimin e Komisionit në kontekstin e së drejtës për akses në gjykatë.
24. *Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni i ka shkelur të drejtën për mbrojtje efektive gjatë seancës dëgjimore, duke penguar përfaqësuesin ligjor të subjektit për t'iu përgjigjur pyetjes së relatores së çështjes, dhe duke kërkuar nga vetë subjekti i rivlerësimit përgjigjen e pyetjes së bërë. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo sjellje e Komisionit është në shkelje të nenit 35 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenit 6, pika 1 e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se mosrespektimi i së drejtës për t'u dëgjuar i ka cenuar rëndë edhe parimet e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në proces, si dhe parimin e ligjshmërisë.*
25. Në shqyrtimin e këtij shkak ankimi, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit, më konkretisht procesverbalin e seancës dëgjimore, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar. Tërheqja e vëmendjes nga ana e relatores së çështjes<sup>7</sup> përfaqësuesit me prokurë të subjektit të rivlerësimit, duke synuar marrjen e sqarimeve të nevojshme nga ana e subjektit të rivlerësimit, lidhur me situatën faktike mbi çështjen objekt diskutimi, përdorimin nga subjekti të automjetit në pronësi të shtetasit A. L., nuk vlerësohet se ka cenuar të drejtën e subjektit për t'u përfaqësuar në procedurën administrative në Komision, referuar parashikimeve të nenit 35 të Kodit të Procedurave Administrative, dhe as vlerësohet të ketë cenuar të drejtën e tij për proces të rregullt, sipas parashikimeve të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, në këndvështrim të garantimit të mbrojtjes efektive, sa kohë përfaqësuesit me prokurë i është dhënë mundësia të shprehet në mbrojtje të klientit të tij pa asnjë lloj kufizimi. Veprimi i relatorit të çështjes për të marrë në pyetje subjektin

<sup>7</sup> Relatorja e çështjes është shprehur: “Të lutem avokat, unë po komunikoj me subjektin e rivlerësimit. Dhe është e drejta ime që të sqarohem nëpërmjet subjektit të rivlerësimit. Do të vlerësoja shumë sikur të mos ndërhynit në pyetjet e mia dhe ta mbarojë subjekti. Ju mund të ndërhyni më pas”. Për më shumë, shih faqen nr. 31 të procesverbalit të seancës dëgjimore.

e rivlerësimit, është në përputhje me parashikimin e nenit 55, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, çmohet nga trupi gjykues në përputhje edhe me parashikimin e nenit 35, pika 3 e Kodit të Procedurave Administrative.

26. *Në lidhje me shkakun e ankimit për vendimmarrje të Komisionit lidhur me dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kundërshtim me parashikimet e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, me pretendimin se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhej as në kushtet e deklaramit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, referuar parashikimit të nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe as në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për figurën dhe pasurinë sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se, sipas subjektit të rivlerësimit, përdorimi i lidhëzës “dhe” në këtë dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative të këtyre dy kushteve (pamjaftueshmërisë lidhur me kriterin e figurës dhe pamjaftueshmërisë lidhur me kriterin e pasurisë), ndërkohë që ai nuk ishte vlerësuar për njërin prej këtyre kriterëve, atij të figurës, trupi gjykues thekson se tashmë Kolegji ka krijuar jurisprudencë të konsoliduar në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me raportin e pavarur që kanë këto dy dispozita në prodhimin e pasojës juridike të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Sikundër dhe sa i takon mënyrës së vlerësimit të secilit kriter rivlerësimi (atij të pasurisë dhe pastërtisë së figurës), e cila është e pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit për secilin kriter objekt shqyrtimi vlerësohet i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë, ky shkak ankimi, në vlerësim të trupit gjykues, është i pabazuar në ligj dhe, si i tillë, nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.*

*C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material*

27. *Lidhur me shkakun e ankimit për kundërshtimin si të padrejtë dhe të pabazuar të konkluzionit të Komisionit për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar likuidimin e çmimit për blerjen e pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sip. 158 m<sup>2</sup>, me vlerë 60.000 euro dhe vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}” (ish-rruga “{\*\*\*}”), pranë {\*\*\*}, Tiranë, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si vijon.*
28. *Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar likuidimin e çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Këtë konkluzion, në vendimin e tij, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin e përmbledhur se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.3.2007 dhe, për rrjedhojë, ka çmuar se janë të karakterit deklarativ dhe të pambështetura në ligj e prova pretendimet e subjektit të rivlerësimit për moskryerjen e pagesës së plotë në shumën prej 60.000 eurosh, gjatë vitit 2007. Parë në dritën e mospërputhjeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si edhe deklarimeve kontradiktore për këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë përpjekje për të fshehur kontratën e porosisë së datës 20.3.2007. Komisioni ka mbajtur qëndrimin që pagesa për blerjen e apartamentit është bërë në vitin 2007 dhe, në këtë kuptim, të ardhurat e pretenduara nga shitja e apartamentit në vitin 2008, nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit objekt kontrolli. Komisioni nuk i ka vlerësuar bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur*

me shitjen e apartamentit në vitin 2008, duke ngritur dyshime të arsyeshme se transaksioni i vitit 2008 është veprim i simuluar, me qëllim, në dukje, justifikimin e burimit të të ardhurave për pagesën e deklaruar nga subjekti gjatë këtij viti për shlyerjen e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi. Bazuar në konkluzionin se pagesa e çmimit prej 60.000 eurosh është kryer me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes në datën 20.3.2007, dhe jo sipas akteve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nisur nga fakti se subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e kursimeve *cash* për vitet 2005 dhe 2006, Komisioni ka vlerësuar gjithashtu se: (i) të ardhurat e pretenduara si të dhuruara nga vëllai i subjektit gjatë vitit 2007, deklaruar si pasuri në formë likuiditetesh gjendje *cash* në fund të vitit 2007; (ii) kursimet e deklaruara në formë likuiditetesh *cash* në lekë për vitet 2005, 2006, 2007, dhe kursimet nga të ardhurat e përfituara gjatë vitit 2008; dhe (iii) kursimet në formë likuiditetesh *cash*, të deklaruara për vitet 2009 dhe 2010, nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për pasurinë objekt vlerësimi.

29. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtimin si të padrejtë dhe të pabazuar të konkluzionit të mësipërm të Komisionit lidhur me këtë pasuri, ka pretenduar se:

29.1. Konkluzioni i Komisionit për pasqyrimin në analizën financiare të blerjes së apartamentit në vitin 2007, është konkluzion i gabuar dhe nuk i përgjigjet realitetit duke rënduar padrejtësisht pozitën e subjektit të rivlerësimit. Subjekti pretendoi se ky konkluzion nuk bazohet në fakte dhe, për këtë qëllim, ka dorëzuar në Komision mandatarkëtimet nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2008 dhe nr. {\*\*\*}, datë 07.12.2011, të lëshuara nga pala sipërmarrëse/shitëse, të shoqëruara edhe me deklaratën noteriale të datës 06.07.2020, të shtetasës E. Xh. (sipërmarrësja dhe shitësja e pasurisë objekt kontrolli), të cilat, sipas tij, janë prova të pakundërshtueshme në drejtim të të provuarit të kohës së kryerjes së pagesave nga ana e tij.

29.2. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka pasur për qëllim fshehjen e kontratës së porosisë së kësaj pasurie, është konkluzion i gabuar, alogjik, paragjykes dhe shtrembërim i qëllimshëm i fakteve dhe rrethanave. Subjekti parashtroi se nëse kjo do ishte e vërtetë, kjo pasuri nuk do ishte deklaruar nga ana e tij në deklaratën periodike të vitit 2008 (vitin pasardhës) para ILDKPKI-së dhe as kontrata nuk do të ishte dorëzuar nga ana e subjektit në ILDKPKI, po në të njëjtin vit. Subjekti i rivlerësimit pranoi se nga ana e tij, nuk është zbatuar në mënyrë rigoroze parashikimi i nenit 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, duke mos deklaruar të drejtat reale mbi këtë pasuri në deklarin periodik të vitit 2007, por ky mosdeklarim nuk ka pasur asnjëherë si qëllim fshehjen. Sipas subjektit të rivlerësimit, qëllimi i ligjit nr. 84/2016 nuk është gjetja e pasaktësive në deklarinet ndër vite, por kryerja e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm për të vlerësuar nëse ka fshehje të pasurive apo mosjustifikim të tyre me burime të ligjshme. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo vendimmarrje e Komisionit bie ndesh edhe me jurisprudencën e Kolegjit, duke referuar shprehimisht në vendimin e Kolegjit nr. 28, datë 23.10.2020<sup>8</sup>.

29.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar përfundimin e Komisionit lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të banimit në Bajram Curri, si të krijuara nga një veprim i simuluar, me qëllim në dukje justifikimin e burimit të të ardhurave për pagesën e deklaruar nga subjekti për shlyerjen e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi. Sipas subjektit të rivlerësimit, arsyetimi i Komisionit se, si rrjedhojë e mosregjistrimit në kohë të kontratës së shitblerjes së apartamentit, ngrihen dyshime të arsyeshme që veprimi është fiktiv, nuk qëndron si në pikëpamje formale juridike, ashtu edhe nga situata faktike. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje

<sup>8</sup> Ky vendim i përket çështjes së subjektit të rivlerësimit F. V..

të sa më sipër, pretendoi se, referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë<sup>9</sup>, nga pikëpamja ligjore, blerësi bëhet pronar i apartamentit në momentin e lidhjes së kontratës dhe jo në momentin e regjistrimit të saj në Regjistrat e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Sipas subjektit të rivlerësimit, neglizhenca e palës blerëse për mosregjistrimin e pasurisë në ZRPP, nuk mund të çojë në konkluzionin se kemi të bëjmë me një veprim fiktiv, pasi, sipas subjektit të rivlerësimit, vërtetimi i faktit që blerësi ka jetuar në këtë apartament që nga viti 2008, është lehtësisht i verifikueshëm. Sa u takon dyshimeve të Komisionit lidhur me çmimin e shitjes, subjekti vlerësoi se ato janë të pabazuara. Përcaktimi i këtij çmimi në kontratë, sipas subjektit, është rrjedhojë e tregut të lirë, i cili vepron mbi bazën e ligjeve të kërkesë-ofertës. Sa i takon prokurës së lëshuar në emër të vëllait, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ajo është lëshuar me qëllim përmbylljen e veprimeve për shitjen e apartamentit, por jo për të kryer veprime fiktive. Sipas subjektit të rivlerësimit, blerësi, i cili donte t'ia shiste apartamentin një personi të tretë duke evituar penaltetet për vonesën në regjistrim, dhe mbajtësi i prokurës (vëllai i subjektit), pa dijeninë e subjektit, kanë realizuar kontratën e shitjes me shtetasit I. K. dhe N. K.. Sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, ai sapo ka marrë dijeni për këtë fakt, ka revokuar prokurën dhe ka kërkuar regjistrimin e kontratës së parë, e cila nuk është anuluar asnjëherë, duke qenë se, sipas subjektit, vëllai i tij, referuar prokurës, nuk ka pasur asnjë tagër përfaqësimi për të anuluar kontratën e lidhur me blerësin, dhe se mungesa e këtij tagri, sipas subjektit të rivlerësimit, e bën çdo kontratë tjetër shitjeje të këtij apartamenti absolutisht të pavlefshme.

**29.4.** Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar edhe konkluzionin e Komisionit lidhur me të ardhurat e deklaruara si burim për blerjen e apartamentit duke pretenduar se:

(i) Lidhur me shumën prej 5.000 GBP të dhuruar nga i vëllai E. D., subjekti i rivlerësimit pretendoi se dyshimet e Komisionit mbi mungesën e logjikës ekonomike për dhurimin e një shume të marrë borxh nga dhuruesi, shpjegohen me faktin se marrëdhëniet e posaçme si ajo mes vëllezërve nuk udhëhiqen nga logjika ekonomike dhe se, lidhur me dorëzimin e dokumentacionit justifikues ligjor për të ardhurat e vëllait, ka dorëzuar në Komision deklaratën e shtetases angleze M. J. C., datë 23 gusht 2021, me vulë *apostille*, në formën e kërkuar nga ligji, duke provuar, sipas tij, se të ardhurat kanë qenë plotësisht të ligjshme. Subjekti i rivlerësimit pranon se, në lidhje me vitin e dhurimit, ka pasur deklarime kontradiktore dhe se kjo lidhet me pakujdesinë e tij në deklarime, pa vënë në dyshim situatën faktike lidhur me dhurimin e kësaj shume në vitin 2007 dhe deklarimin e këtij fakti para ILDKPKI-së në deklaratën periodike të të njëjtit vit. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjithashtu në ankim se, nga ana e Komisionit, i është kaluar një barrë prove joproportionale në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të shtetases angleze në vitin 2005, pasi jo vetëm për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, kjo shtetase e ka të pamundur të sigurojë dokumentacion justifikues ligjor në shtetin e saj në lidhje me taksat e paguara në vitin 2005, por një kërkesë e tillë, sipas subjektit të rivlerësimit, bie ndesh edhe me jurisprudencën e Kolegjit në lidhje me ligjshmërinë e burimit të pasurive të personave të tjerë të lidhur, duke referuar shprehimisht në vendimin e Kolegjit nr. 28 (JR) datë 30.10.2019.

(ii) Lidhur me kursimet e deklaruara më parë në gjendje *cash*, subjekti i rivlerësimit pretendoi se qëndrimi i Komisionit vjen në kundërshtim me situatën faktike dhe, si rrjedhojë e mungesës së analizimit të provave dhe shpjegimeve të paraqitura prej tij në përgjigjet e pyetësorëve të Komisionit dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit. Subjekti pretendoi se mosdeklarimi i pakësimit të kursimeve në vitet 2005, 2006, 2007, ka ndodhur për shkak të faktit se këto kursime

<sup>9</sup> Me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nr. 1, datë 06.01.2009.

nuk janë pakësuar në vitin 2007 dhe deklaratimet e tij kanë qenë në përputhje me situatën faktike lidhur me pagesën e parë për blerjen e apartamentit në vitin 2008. Sipas subjektit të rivlerësimit, po ashtu në kundërshtim me situatën faktike, vjen edhe analiza financiare e kryer nga Komisioni, e cila është bazuar në konkluzionin tjetër të gabuar të Komisionit se kursimet në formë likuiditetesh *cash* në vitet 2009, 2010 nuk mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi.

30. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin gjyqësor të çështjes dhe arsyetimin e Komisionit në vendim, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

- *Lidhur me origjinën e pasurisë objekt kontrolli dhe kohën e kryerjes së pagesës/ave për financimin e blerjes së apartamentit:*

31. Me kontratën e porosisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.03.2007, të lidhur para noteres L. K., znj. E. Xh., referuar në kontratë si “Sipërmarrësi & Investitori” dhe subjekti i rivlerësimit Izet Dushaj kanë rënë dakord që znj. Xh. t’i shesë z. Dushaj një apartament në katin III të banimit, me sipërfaqe 169 m<sup>2</sup>, në një godinë banimi të ndërtuar në truallin në pronësi të znj. Xh., në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Godina ku ndodhet apartamenti objekt i kësaj kontrate, referohet të jetë në proces legalizimi. Referuar nenit 2 të kësaj kontrate, çmimi i shitblerjes është përcaktuar nga palët në vlerën 60.000 euro. Sipas të njëjtit nen, rezulton se *me nënshkrimin e kësaj kontrate, është likuiduar shuma totale për shitblerjen e apartamentit me të dhënat e mësipërme*, duke bërë që palët të referohen në kontratë si të likuiduar në raport me pagesën e çmimit të apartamentit.

32. Me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.01.2011, të lidhur para së njëjtës notere, mes znj. E. Xh. në cilësinë e shitëses dhe z. Izet Dushaj në cilësinë e blerësit, është rënë dakord që shitësja e cila ka në pronësinë e saj pasurinë e paluajtshme të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. {\*\*\*}, datë 28.12.2010, me nr. pasurie {\*\*\*}, ZK {\*\*\*}, me sip. 158 m<sup>2</sup>, në katin e tretë të godinës së ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, t’ia shesë atë subjektit të rivlerësimit kundrejt çmimit prej 60.000 eurosh. Referuar përmbajtjes së kësaj kontrate, lidhur me pagesën e çmimit të shitblerjes, është përcaktuar: *Blerësi Izet Dushaj e pranon blerjen e pronës, si dhe likuidon shitësin plotësisht jashtë zyrës në të cilën redaktohet ky akt.*

33. Kjo marrëdhënie kontraktuale konstatohet të jetë pasqyruar në deklaratimet periodike të kryera nga subjekti i rivlerësimit para ILDKPKI-së në vitet 2008 dhe 2011 si vijon:

33.1. Në rubrikën e ndryshimeve të pasurive dhe interesave privatë të deklaratës periodike të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e apartamentit me sipërfaqe 98 m<sup>2</sup>, ndodhur rr. “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, në vitin 2008, me të ardhurat e siguruar nga shitja e apartamentit në qytetin e Bajram Currit, pakësimi i gjendjes *cash* të akumuluar në vitet 2005, 2006 dhe 2007 në vlerën 1.100.000 lekë, pakësimi i gjendjes *cash* 5.000 GBP dhe pjesa e mbetur nga kursimet e vitit 2008. Referuar kësaj deklarate, trupi gjykues konstatoi se vlera e kësaj pasurie është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në shumën e 50.000 eurove.

33.2. Në vijim, në deklaratën periodike të vitit 2011, në rubrikën përkatëse të ndryshimeve të pasurive dhe interesave privatë, subjekti ka deklaruar: *Ap. sip. 98 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, {\*\*\*}, të deklaruar më parë në bazë të kontratës së sipërmarrjes, është hipotekuar së bashku me një shtesë me sip. 60 m<sup>2</sup>, ngjitur në bazë të kontratës së dt. 03.01.2011. Shënim: Vlera prej 50.000*

*eurosh është paguar dhe deklaruar më parë, ndërsa vlera prej 10.000 eurosh është paguar në momentin e lidhjes së kontratës për hipotekim. Kjo vlerë është nga pakësimi i gjendjes cash dhe të ardhura nga pagat.*

34. Trupi gjykues vëren se lidhur me krijimin e kësaj pasurie dhe momentin e kryerjes së pagesës për çmimin e shitblerjes, subjekti i rivlerësimit rezultoi të jetë pyetur ndër vite nga ILDKPKI-ja, sikundër edhe nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet pyetësorëve drejtuar këtij të fundit. Nga përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren në mënyrë të përmbledhur se:

(i) Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në vitin 2011<sup>10</sup>, lidhur me mospërputhjet e konstatuara mes deklaratave periodike të viteve 2007 dhe 2008, kontratës së porosisë nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., të datës 20.03.2007, të dorëzuar prej tij në ILDKPKI, lidhur me momentin e blerjes së kësaj pasurie dhe vlerës së saj, si dhe faktit të mosdeklarimit në deklaratën periodike të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur: *Pavarësisht kontratës së porosisë, kam paguar për blerjen e këtij apartamenti në V. 2008, siç kam deklaruar në D.I.P të vitit 2008, me të ardhurat e siguruara nga shitja në shumën 30.000 euro të apartamentit që kisha në pronësi në lagjen “{\*\*\*}” në qytetin B. Curri më datë 06.11.2008, dhe kursime të deklaruara më parë. Pavarësisht kësaj kontrate porosie, kisha rënë dakord me palën shitëse që do ta bëja likuidimin total të saj me përfundimin e plotë të pronës dhe regjistrimin e saj në ZRPP, pasi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, godina ishte në proces legalizimi, kjo është arsyeja që e kam deklaruar këtë apartament në shumën 50.000 euro. Për sa i takon sipërfaqes, nuk kam qenë i saktë pasi nuk kam pasur kontratën e porosisë në momentin e deklarimit.*

(ii) Në vitin 2014, në shpjegimet e dhëna para të njëjtit institucion<sup>11</sup>, lidhur me burimin e krijimit për pagesat e kryera për blerjen e apartamentit të deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2008, sipërfaqen, çmimin dhe kohën kur janë kryer pagesat, subjekti është përgjigjur<sup>12</sup> se: *në lidhje me apartamentin që ndodhet në rrugën “{\*\*\*}”, të deklaruar në vitin 2008 me sipërfaqe 98 m<sup>2</sup>, e blerë me çmimin 50.000 euro, me burim krijimin e këtij asemi, 30.000 euro të përfituara nga [...], sqaroj se në momentin e hipotekimit të këtij apartamenti nga firma, kam marrë edhe një shtesë 60 m<sup>2</sup>, ngjitur me apartamentin tim, me një çmim prej 10.000 eurosh, të pasqyruara në momentin e lidhjes së kontratës së hipotekimit, të plotësuar nga pakësimi i gjendjes cash dhe të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes. [...]*

(iii) Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se, për shkak të njohjes familjare dhe lidhjeve miqësore me shtetasen E. Xh., e cila kishte ndërtuar një objekt në rrugën “{\*\*\*}”, ka marrë dijeni se ajo kishte apartamente në shitje në një objekt në proces legalizimi dhe, duke qenë se në atë kohë nuk kishte paratë e nevojshme për blerjen e apartamentit, ka rënë dakord për mundësinë e blerjes së apartamentit objekt kontrolli, i cili ishte i papërfunduar në të gjithë sipërfaqen e tij, por vetëm në pjesën prej 98 m<sup>2</sup>, ndërsa pjesa tjetër e tij, prej 60 m<sup>2</sup>, nuk i kishte përfunduar të gjitha punimet. Sipas subjektit, për shkak të miqësisë familjare me këtë shtetase, kanë rënë dakord që një pjesë të pagesës ta bënte pasi të shiste

<sup>10</sup> Shih procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 08.07.2011, lidhur me pasaktësitë e konstatuara në deklaratat e pasurisë së z. Izet Dushaj, të përpiluar nga inspektorja R. R..

<sup>11</sup> Referuar procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 05.11.2014, lidhur me pasaktësitë e konstatuara në deklaratat e pasurisë së z. Izet Dushaj për periudhën para fillimit në detyrë e deri më 31.12.2013, ky i fundit është pyetur nga inspektorja Dh. S.

<sup>12</sup> Shih materialin e përcjellë ILDKPKI-së nga subjekti i rivlerësimit më datë 16.11.2014.

shtëpinë në Bajram Curri dhe pjesën tjetër kur të përfundonin punimet në pjesën e papërfunduar, si dhe kur të bëhej legalizimi i banesës. Subjekti pretendoi se, për nevoja të formalizimit të kësaj marrëveshjeje dhe marrëdhënies së mirëbesimit, si dhe për efekt të lidhjes së kontratave të shërbimeve utilitare, kanë nënshkruar kontratën e porosisë me shtetasen E. Xh., më datë 20.03.2007, me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., në bazë të së cilës subjekti do të blinte një apartament me sipërfaqe 168 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit prej 60 000 eurosh, pa i kushtuar vëmendjen e duhur nenit 2 të kësaj kontrate tip, ku thuhej se çmimi prej 60.000 eurosh ishte likuiduar plotësisht. Në vazhdim, subjekti shpjegoi edhe se: *Pagesën e parë për blerjen e këtij apartamenti, në shumën prej 50.000 eurosh, e kam bërë në vitin 2008, kohë në të cilën kisha shitur shtëpinë në Bajram Curri, duke shtuar dhe kursimet e mia, si dhe një shumë të dhuruar nga vëllai im, shtetasi E. D., i cili jetonte dhe vazhdon të jetojë në Mbretërinë e Bashkuar. Në deklarimin e vitit 2008 kam pasqyruar këtë pagesë duke përcaktuar sipërfaqen 98 m<sup>2</sup>, pasi ajo ishte sipërfaqja që shfrytëzoja realisht, pasi pjesa tjetër nuk kishte përfunduar akoma. Me përfundimin e plotë të punimeve dhe legalizimin e objektit në vitin 2011, kam bërë pagesën e shumës prej 10.000 eurosh dhe kam lidhur kontratën përfundimtare të shitjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 3.1.2011. Të gjitha pagesat janë bërë me para në dorë. Këtë apartament e kam marrë në dorëzim në shtator të vitit 2007 [...].*

(iv) Në shpjegimet e dhëna ndaj rezultateve të hetimit, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, pasi ka ripërsëritur sa shpjeguar në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, ka saktësuar për herë të parë momentin konkret kohor kur pretendon të ketë kryer pagesat lidhur me shlyerjen e çmimit të apartamentit dhe, në mbështetje të sa deklaruar, ka depozituar edhe dy mandatar-këtime. Referuar këtyre dy mandatar-këtimeve, rezulton se sipas mandatit të parë nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2008, nga z. Izet Dushaj është paguar vlera prej 50.000 eurosh, me përshkrimin “Kësti i parë për shtëpi”. Kjo shumë është arkëtuar nga E. Xh. dhe mbi nënshkrimin e saj ka një vulë me këto të dhëna: *Hotel {\*\*\*}, rruga “{\*\*\*}”, nr. {\*\*\*}, Tiranë, Albania*. Sipas mandatit të dytë të arkëtimit me nr. {\*\*\*}, datë 7.12.2011, konstatohet se nga z. Izet Dushaj është paguar vlera prej 10.000 eurosh, me përshkrimin “Kësti i dytë për shtëpi”. Kjo shumë është arkëtuar nga E. Xh. dhe mbi nënshkrimin e saj ka një vulë me të njëjtat të dhëna si në mandatin e parë. Nga një verifikim i kryer në faqen zyrtare në internet të Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se shtetasja E. Xh. është e regjistruar në regjistrin tregtar si person fizik me NUIS {\*\*\*} që në vitin 2000, me objekt aktiviteti “Hotel, prodhim dhe shitje energjie”, me adresë të ushtrimit të aktivitetit në rrugën “{\*\*\*}”, aktualisht e çregjistruar. Subjekti tregtar, më datë 08.04.2020, ka kaluar në status “pezulluar” dhe në vijim, në datën 14.01.2021, rezulton të jetë çregjistruar.

35. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerësoi fillimisht se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për konkluzion të gabuar të Komisionit, sipas të cilit *subjekti i rivlerësimit ka bërë përpjekje për të fshehur kontratën e porosisë së datës 20.3.2007*, gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte, referuar sa konstatuar më sipër në dy procesverbalet e përpiluara nga inspektorët e ILDKPKI-së, në vitet 2011 dhe 2014, sipas të cilave rezultoi se kjo kontratë ishte depozituar në ILDKPKI nga vetë subjekti i rivlerësimit.
36. Pavarësisht këtij fakti, në analizë të gjithë sa konstatuar më sipër lidhur me dinamikën e marrëdhënies së krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasës E. Xh., në cilësisë e saj si shitëse e pasurisë objekt kontrolli, si dhe deklarimeve e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit para ILDKPKI-së ndër vite dhe para Komisionit gjatë hetimit administrativ, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues arriti në përfundimin se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me momentin e kryerjes së pagesave për blerjen e apartamentit, nuk arritën nivelin e të

shpjeguarit bindshëm, në kuptim të parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe pranimit, për pasojë, të pretendimeve të subjektit si të bazuara në fakte.

37. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion pasi mori në analizë dhe vlerësoi nga njëra anë qëndrimin konsistent të subjektit të rivlerësimit në lidhje me mosshlyerjen e çmimit të plotë prej 60.000 eurosh që në momentin e lidhjes së kontratës me shtetasen E. Xh., por pagesën e tij në dy periudha të ndryshme, përkatësisht në vitet 2008 dhe 2011, dhe nga ana tjetër parashikimet në aktet noteriale që kanë formalizuar marrëdhënien juridike-civile të krijuar në dinamikë mes palëve, lidhur me tjetërsimin e të drejtave të pronësisë së apartamentit objekt kontrolli.
38. Parashikimi në kontratën e shitblerjes të datës 03.01.2011, se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e blerësit *pranon blerjen e pronës, si dhe likuidon shitësin plotësisht jashtë zyrës në të cilën redaktohet ky akt*, ndonëse nuk konfirmon në mënyrë të shprehur dakordësinë e palëve sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 20.03.2007, sipas së cilës çmimi i plotë i apartamentit ishte likuiduar, rezultoi gjithashtu se nuk pasqyronte as faktin e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit për kryerjen e pagesës së kështit të parë prej 50.000 eurosh, sipas mandatarkëtimit të dorëzuar nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2008, dhe as detyrimin e mbetur për pagesë të diferencës së çmimit prej 10.000 eurosh, të pretenduar si të paguar në datën 07.12.2011, referuar mandatit të dorëzuar në Komision.
39. Trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe mospërputhjen e rezultuar nga shqyrtimi i mandatarkëtimit nr. {\*\*\*}, datë 07.12.2011, sipas të cilit rezultoi se pagesa e kështit të dytë ishte bërë rreth 11 muaj më vonë nga lidhja e kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 03.01.2011, ndërkohë që në DIPPV-në e vitit 2011, në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe gjatë hetimit në Komision, vetë subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar që kjo pagesë ishte kryer në momentin e lidhjes së kontratës për hipotekim.
40. Në këto kushte, në konsideratë edhe të kuadrit kushtetues e ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit kalimtar, i cili i ngarkon subjektet e rivlerësimit me barrën e provës për të kundërtën e gjetjeve të rezultuara nga hetimi administrativ, në përmbushje të detyrimit kushtetues të përcaktuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tyre, trupi gjykues e gjeti konkluzionin e Komisionit për kryerjen e pagesës së plotë të çmimit të apartamentit, në shumën prej 60.000 eurosh, gjatë vitit 2007, të bazuar në një vlerësim korrekt të gjetjeve nga rezultatet e hetimit të kryer. Bazuar në këtë qëndrim, konkluzioni i Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pagesën e çmimit sipas parashikimit në kontratën e sipërmarrjes, në shumën e 7.137.315 lekëve, rezultat ky sipas një analize të ardhurash dhe shpenzimesh të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të për periudhën 01.01.2007 - 20.03.2007, pa përfshirë burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në versionin e kryerjes së kësaj pagese në vitet 2008 dhe 2011, u gjet i bazuar edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj.
41. Përveç sa më sipër konkluduar, në konsideratë të faktit që qëndrimi i subjektit të rivlerësimit jo vetëm në kontekst të deklarimit të tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, por edhe në referim të deklarimeve periodike, si dhe qëndrimeve në vazhdimësi para ILDKPKI-së dhe Komisionit ka qenë konsistent në drejtim të periudhës së kryerjes së pagesave dhe burimeve të përdorura, trupi gjykues, në kuadër të arritjes së një vendimmarrjeje sa më objektive, vlerësoi të merrte në analizë dhe të verifikonte edhe mundësinë e tij financiare për të kryer pagesat për blerjen e apartamentit sipas kalendarit të deklaruar prej tij, ku pagesa e parë, në shumën e 50.000 eurove, të merret në analizë si e shlyer në datën e mandatarkëtimit nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2008 dhe pagesa e dytë prej

10.000 eurosh, sipas deklaratimit të subjektit në deklaratën periodike të vitit 2011, si e shlyer deri në datën 3.1.2011, datë në të cilën është lidhur kontrata e shitblerjes, duke i hapur rrugën regjistrimit të pasurisë në ZVRPP Tiranë. Në kuadër të kësaj analize garantiste në drejtim të pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me burimet e deklaruara të të ardhurave për pagesën e apartamentit, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

42. Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga shitja e apartamentit në Bajram Curri, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten dhe nënën e tij, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, trupi gjykues vëren se situata faktike e konstatuar nga Komisioni në vendim, lidhur me ekzistencën e dy kontratave të shitblerjes së të njëjtit apartament banimi me sip. 82 m<sup>2</sup>, në Bajram Curri, dy blerësve të ndryshëm, një në vitin 2008 dhe tjetra në vitin 2011, është e saktë dhe e plotë.
43. Në mënyrë të përmbledhur, trupi gjykues konstatoi se në nëntor të vitit 2008, mes subjektit të rivlerësimit dhe bashkëpronarëve të tjerë në cilësinë e shitësve dhe z. A. G. në cilësinë e blerësit është lidhur një kontratë shitblerjeje para noteres E. A. me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 06.11.2008, me çmim shitjeje 30.000 euro, kontratë kjo e paregjistruar në ZVRPP, deri në vitin 2018. Ndërkohë, referuar të dhënave të administruara nga ASHK, ka rezultuar një kontratë shitjeje e të njëjtit apartament (disa ditë pasi kjo pasuri është rivlerësuar më datë 17.10.2011, me vlerën 2.238.6000 lekë) e lidhur përpara së njëjtës notere, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.10.2011, nga nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. H. D., dhe vëllai i tij, z. R. D., ky i fundit si përfaqësues me prokurë<sup>13</sup> i subjektit dhe bashkëshortes së tij, në cilësinë e shitësve, dhe z. I. K. në cilësinë e blerësit, me çmim shitjeje 2.200.000 lekë dhe e regjistruar në ZVRPP menjëherë pas lidhjes. Kjo kontratë rezultoi të jetë revokuar në vijim në vitin 2018, sipas deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.06.2018, të të njëjtave palë, dhënë para noterit I. H.. Si pasojë e këtij fakti, kjo kontratë është çregjistruar dhe në vijim është regjistruar, për efekt të kalimit të së drejtës së pronësisë së apartamentit objekt verifikimi, kontrata e lidhur në vitin 2008 me palë blerëse z. A. G..
44. Në analizë të kësaj situatë faktike, vlerësimi se cila prej kontratave të mësipërme është ajo që ka prodhuar *de facto* të ardhurat nga kalimi i titullit të pronësisë së apartamentit në Bajram Curri, në vlerësim të trupit gjykues, merr rëndësi thelbësore për efekt të nevojave të procesit të rivlerësimit, në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit lidhur me verifikimin e burimeve të krijimit të pasurisë së blerë në Tiranë. Në këtë kuptim, pretendimet dhe argumentet e subjektit të rivlerësimit lidhur me efektin e vendimit unifikues nr. 1, datë 06.01.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat fokusohen në drejtim të analizës se cila është kontrata e pavlefshme në kuptim të vlerësimit të rregullsisë së kalimit të titullit të pronësisë *per se*, u çmuan pa ndonjë efekt në rastin objekt gjykimi.
45. Trupi gjykues vërejti gjithashtu se është fakt, i konfirmuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, se njëra prej kontratave të sipërcituara është përpiluar për qëllime të caktuara, jo në përputhje me parashikimet ligjore dhe, në këtë kontekst, vlerësimi mbi besueshmërinë e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit mbi faktin se kontrata reale që ka prodhuar të ardhurat nga shitja është ajo e vitit 2008 dhe jo ajo e lidhur në vitin 2011, mbeti një vlerësim hipotetik i trupit gjykues sipas një qasjeje garantiste në kuadër të një vlerësimi alternativ të krijimit të pasurisë objekt kontrolli, pasi, nga hetimi administrativ i zhvilluar në Komision, nuk kishte rezultuar asnjë e dhënë në drejtim të

---

<sup>13</sup> Sipas prokurës së posaçme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.10.2011, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit para noteres R. H..

arkëtimit të pagesës së kryer në kuadër të marrëdhënies së shitblerjes, për të arritur në një konkluzion të qartë se cila ishte kontrata që kishte krijuar *de facto* të ardhurat nga shitja.

46. Sa i takon vlerësimin të burimit të të ardhurave në shumën 5.000 GBP, të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2007 si “dërguar nga vëllai nga Anglia” dhe gjendje *cash* në banesë në datën 31 dhjetor të këtij viti, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes, konstatoi se pavarësisht deklarimeve kontradiktore të konstatuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, lidhur me kohën dhe vendin e marrjes së kësaj shume të dhuruar nga vëllai, z. E. D., pranuar këto problematika në deklaratimet e dhëna ndër vite edhe nga vetë subjekti, vlerësimi përfundimtar i këtij burimi, në kuadër të kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, përveç kontradiktave të konstatuara, është bazuar në faktin se për këtë dhurim, nuk u arrit të provohej me dokumentacion justifikues ligjshmëria e burimit të të ardhurave të dhuruesit. Në këtë kuptim, trupi gjykues, pasi çmoi se verifikimi lidhur me ligjshmërinë e këtij burimi të deklaruar të ardhurash është kryer në përputhje me parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe interpretimit të tij nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit, sipas të cilit subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, të cilët deklarohen në cilësinë e dhuruesit, kanë barrën e provës për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të dhuruara, arriti në përfundimin se në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar kërkesat e dispozitës së sipërcituar për dorëzimin e dokumentacionit justifikues lidhur me burimin e të ardhurave të përdorura për dhurimin nga i vëllai, në përmbushje të standardit të përcaktuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës mbi ligjshmërinë e të ardhurave, duke mos u provuar burimi i ligjshëm i tij, kjo shumë vlerësohet se edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj, nuk plotëson kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës për t’u vlerësuar si burim financiar i ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt kontrolli.
47. Në lidhje me vlerësimin e kursimeve gjendje *cash* në banesë dhe mjaftueshmërisë së këtyre kursimeve të deklaruar si burim për pagesat e kryera në vitin 2008 dhe 2011, trupi gjykues, pasi kreu verifikimet e nevojshme nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
- 47.1. Referuar deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike të viteve 2005, 2006 dhe 2007, ky i fundit ka deklaruar kursime *cash* në banesë nga 300.000 lekë për vitet 2005 e 2006 dhe për vitin 2007, krahas deklaratimit të gjendjes *cash* në valutë, në shumën 5.000 GBP, “dërguar nga vëllai nga Anglia”, ka deklaruar edhe kursime të vitit në shumën 500.000 lekë, në total kursime *cash* në shumën 1.330.100 lekë<sup>14</sup>. Nga analiza financiare e kryer për vitin 2005, e cila ka rezultuar me balancë negative në shumën (-) 68.179 lekë, konstatohet se kursimet e deklaruar gjendje *cash* me burime të ligjshme përllogariten në shumën e 231.821 lekëve. Për vitin 2006, duke qenë se analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar me balancë pozitive, kursimi *cash* i deklaruar në këtë vit, në shumën 300.000 lekë, rezulton me burime të ligjshme. Ndërsa për vitin 2007, nëse nuk përllogaritet pagesa e kryer për blerjen e apartamentit në shumën prej 60.000 eurosh, si dhe gjendja *cash* nga dhurimi i shumës prej 5.000 GBP, e cila është e pajustificuar për shkak të mungesës së dokumentacionit justifikues të dhuruesit dhe jo mungesës së të ardhurave të subjektit, analiza financiare e vitit 2007 do të përllogaritet me balancë negative në shumën (-) 189.307 lekë. Për rrjedhojë, kursimi *cash* i justifikuar me burime të ligjshme për këtë vit, do të përllogaritet në

<sup>14</sup> Kursimet *cash* të deklaruar në DIPP-në e vitit 2007, janë shumatore e vlerës së konvertuar në 830.100 lekë, të dhurimit prej 5.000 GBP, dhe kursimit të vitit të deklaruar prej 500.000 lekësh.

shumën e 310.693 lekëve<sup>15</sup>. Në përfundim, kursimi *cash* i krijuar nga subjekti për periudhën 2005-2007, i justifikuar me burime të ligjshme, përlllogaritet në shumën 842.514 lekë.

47.2. Ndërkohë, referuar analizës financiare të kryer për periudhën 2009-2011, mbi verifikimin e mundësisë së krijimit të kursimeve *cash* me burime të ligjshme, nga kontrolli i kryer ka rezultuar se për vitin 2009, i cili ka rezultuar me balancë negative prej (-) 133.324 lekësh, kursimi *cash* i deklaruar në këtë vit, në shumën 400.000 lekë, nuk justifikohet tërësisht me burime të ligjshme, duke rezultuar si i tillë vetëm shuma prej 266.676 lekësh. Ndërsa për vitin 2010, i cili ka rezultuar me balancë negative prej (-) 449.057 lekësh, kursimi *cash* i deklaruar në këtë vit, në shumën 600.000 lekë, përlllogaritet i justifikuar me burime të ligjshme vetëm për shumën prej 150.943 lekësh. Për rrjedhojë, kursimi *cash* i justifikuar me burime të ligjshme, për periudhën 2009-2010, përlllogaritet në total në shumën 417.619 lekë.

48. Në përmbledhje të sa më sipër, në kuadër të verifikimit nga trupi gjykues sipas këtij vlerësimi alternativ, të mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për të kryer pagesat për blerjen e apartamentit në shumën e 50.000 eurove në datën 20.11.2008 dhe në shumën e 10.000 eurove në datën 3.1.2011, nëpërmjet kryerjes së një analize financiare pjesore deri në datat e sipërcituara të kryerjes së pagesave, duke pranuar si burime për këto pagesa si më sipër trajtuar, të ardhurat nga shitja e apartamentit në Bajram Curri në vitin 2008 dhe pakësimin e gjendjes *cash* në shumën e justifikuar me burime të ligjshme, konstatohet se: (i) për pagesën e parë prej 50.000 eurosh, do të rezultonte mungesë e burimeve të ligjshme në shumën e 1.228.623 lekëve; ndërsa (ii) për pagesën e dytë prej 10.000 eurosh, do të rezultonte mungesë e burimeve të ligjshme në shumën e 965.381 lekëve<sup>16</sup>. Në total, për blerjen e apartamentit, edhe sipas kësaj analize me garantiste në pranimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit do të rezultonte përsëri me mungesë të burimeve të ligjshme në shumën totale prej 2.194.004 lekësh. Kjo mungesë burimesh të ligjshme financiare konstatohet të jetë më e lartë se pragu i aplikuar nga jurisprudenca e Kolegjtit, sipas parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës disiplinore në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
49. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 158 m<sup>2</sup>, të porositur në vitin 2007 në vlerën 60.000 euro, me vendndodhje në rrugën “{\*\*\*{” (ish-rruga “{\*\*\*}”), Tiranë, nga kontrolli i kryer në Kolegj në drejtim të verifikimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për pagesën e çmimit të apartamentit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
50. Lidhur me *pasurinë e luajtshme të llojit automjet, të tipit “Audi A6”, blerë në vitin 2012, të deklaruar në vlerën e 5000 (pesë mijë) eurove*, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

---

<sup>15</sup> Kursimi gjendje *cash*, i justifikuar me burime të ligjshme nga të ardhurat e subjektit, përlllogaritet 500.000 lekë - 189.307 lekë = 310.693 lekë.

<sup>16</sup> Për kryerjen e pagesës së kësaj të dytë në shumën prej 10.000 eurosh, në datë 03.01.2011 (e konvertuar sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në shumën 1.383.000 lekë), vetëm shuma e kursyer *cash* deri në fund të vitit 2010, e përlllogaritur në shumën 417.619 lekë, përlllogaritet me burime të ligjshme, duke rezultuar diferencën në shumën prej 965.381 lekësh me burime të pajustificuara (1.383.000 lekë - 417.619 lekë = 965.381 lekë).

51. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë së luajtshme të llojit automjet, të tipit “Mercedes-Benz”, blerë në datën 26.07.2016, në vlerën e 600.000 lekëve, për blerjen e të cilit ishin deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* si burim të ardhurat e përfituara nga shitja e një autoveture e markës “Audi A6”, e deklaruar në vitin 2012 [...], pasi kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2012 – 24.5.2012, me qëllim verifikimin e mundësisë të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen e pagesës në shumën 1.005.891 lekë për blerjen dhe zhdoganimin e automjetit të markës “Audi”, ka arritur në konkluzionin se: *Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht shpenzimet e kryera në vitin 2012 për blerjen e automjetit të markës “Audi”, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*
52. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar, në kundërshtim me ligjin dhe rezultat i një hetimi të cunguar, konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit “Audi A6” në vitin 2012. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni, pa asnjë arsye, nuk ka marrë në konsideratë marrjen e huasë nga shtetasi F. C., duke mos e përfshirë atë në analizën financiare për vlerësimin e ligjshmërisë së krijimit të kësaj pasurie, edhe pse, sipas tij, kjo hua është konfirmuar nga ky shtetas, ai ka pasur burime të ligjshme për dhënien e saj dhe ajo është shlyer në fund të vitit me të ardhurat nga paga. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se Komisioni nuk ka hetuar plotësisht lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke qenë se, sipas tij, nuk i ka bërë asnjë pyetje lidhur me këtë çështje nëpër pyetësorë dhe se i ka kaluar direkt barrën e provës në lidhje me këtë pasuri në raportin përfundimtar të hetimit.
53. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues konstatoi fillimisht se pasuria e luajtshme e tipit “Audi A6”, blerë në vitin 2012 dhe e shitur në vitin 2016, është një pasuri e cila nuk ka qenë objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe rezulton të jetë përfshirë në deklarim në kuadër të deklarimit të një tjetër pasurie të luajtshme, automjetit të tipit “Mercedes-Benz” të blerë në vitin 2016, i cili është vlerësuar përfundimisht si pasuri e ligjshme, ndonëse të ardhurat për krijimin e saj janë konstatuar se vijnë nga shitja e pasurisë objekt kontrolli sipas këtij shkak ankimi (automjeti tip “Audi”, i blerë në vitin 2012), e vlerësuar me mungesë të burimeve të ligjshme.
54. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se konkluzioni i arritur nga Komisioni lidhur me automjetin tip “Audi A6”, i blerë në vitin 2012 dhe i shitur në vitin 2016, krijon pasoja vetëm në drejtim të rezultatit të analizës financiare të vitit 2012, pa u shoqëruar me konkluzione lidhur me këtë pasuri në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që u përket pasurive objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting*.
55. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit mbi kundërshtimin e analizës financiare të kryer nga Komisioni për vlerësimin e ligjshmërisë së blerjes në vitin 2012 të automjetit të tipit “Audi A6”, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes lidhur me krijimin e kësaj pasurie, si dhe kontrolli arsyetimin e Komisionit mbi bazën e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
- 55.1. Automjeti i tipit “Audi A6” rezulton të jetë blerë sipas kontratës së shitjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.5.2012, të lidhur para noteres publike Xh. B. kundrejt çmimit prej 5.000

eurosh. Në datë 24.5.2012, janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti dhe janë paguar detyrimet doganore në shumën 307.291 lekë. Vlera e shpenzuar nga subjekti deri në datën 24.05.2012, për blerjen dhe zhdoganimin e këtij mjete, është përlllogaritur në shumën 1.005.891 lekë.

55.2. Në deklaratën periodike të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën përkatëse, e ka deklaruar këtë pasuri të blerë në vitin 2012, me të ardhura nga pagat në vlerën e “5000 (pesë mijë) eurove”. Ky deklaram konstatohet në linjë me deklaramin e kryer nga subjekti i rivlerësimit edhe në vitin 2017 në deklaratën e pasurisë vetting, si evidentuar: *Shuma 600.000 lekë është siguruar nga të ardhurat e përfituara nga shitja e një autoveture e markës “Audi A6”, e deklaruar në vitin 2012 e blerë në shumën 5000 euro dhe shitur në vitin 2016 në bazë të kontratës Sh/B me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 06.07.2016, në vlerën 990.000 lekë. Pasuri e vënë nga të ardhurat nga pagat dhe e deklaruar në vitin 2012.*

56. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni, pa asnjë arsye, nuk ka marrë në konsideratë marrjen e huasë nga shtetasi F. C., duke mos e përfshirë atë në analizën financiare për vlerësimin e ligjshmërisë së krijimit të kësaj pasurie, u gjetën nga trupi gjykues të pabazuara në fakte, për sa kohë nga shqyrtimi i dokumentacionit justifikues të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të përmbysjes së barrës së provës për rezultatin negativ të analizës së kryer lidhur me këtë pasuri, nuk u konstatua asnjë e dhënë që mund të provonte marrëdhënien e pretenduar të huasë mes subjektit të rivlerësimit dhe z. F. C., përveç deklaratës noteriale të shtetasit F. C. nr. rep., {\*\*\*} dhe nr. kol., {\*\*\*}, datë 10.09.2021, dorëzuar nga subjekti në përgjigjet e rezultateve të hetimit, në të cilën z. C. deklaroi se *i ka dhënë hua subjektit, me para në dorë, shumën prej 400.000 lekësh në maj të vitit 2012, për blerjen e një makine, dhe se kjo hua i është kthyer në të njëjtën mënyrë nga subjekti me para në dorë, në dhjetor të vitit 2012.* Kjo deklaratë e vetme, e prezantuar pas përfundimit të hetimit administrativ dhe e pambështetur nga prova apo indicie të tjera, u vlerësua nga trupi gjykues pa vlerë provuese.
57. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në fakte analizën financiare të kryer nga Komisioni për verifikimin e burimeve të ligjshme për shpenzimin e kryer për blerjen e këtij automjeti, bazuar vetëm në burimin e deklaruar, “të ardhurat nga paga”. Rrjedhimisht, bazuar në sa më sipër, nga kontrolli i ushtruar analizës financiare të kryer nga Komisioni, trupi gjykues arrin në të njëjtin konkluzion si ky i fundit, që subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në shumën e 672.845 lekëve, për shlyerjen e çmimit të automjetit dhe pagesën e kryer për mbulimin e shpenzimeve doganore përkatëse.
58. Trupi gjykues, pasi kreu verifikimet e nevojshme nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor në analizën financiare të Komisionit lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie dhe analizën tërësore të vitit 2012, konstatoi se edhe në eventualitetin e marrjes në konsideratë të kësaj huaje në shumën e 400.000 lekëve dhe të shlyer nga subjekti i rivlerësimit brenda vitit, rezultati i analizës financiare për financimin e blerjes dhe mbulimin e shpenzimeve të zhdoganimit do të rezultonte me mungesë të burimeve të ligjshme në shumën e 272.845 lekëve, ndërsa rezultati negativ i analizës së vitit financiar 2012 do të mbetej i pandryshuar në shumën e përlllogaritur prej 626.693 lekësh nga Komisioni, për shkak të efektit financiar që sjell shlyerja e huasë deri në dhjetor të këtij viti, si pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.
59. Lidhur me *përdorimin e sendit të luajtshëm të llojit automjet, të tipit “Volkswagen 3C Passat”, me targë {\*\*\*}, në pronësi të shtetasit F. B.,* trupi gjykues vëren se:

60. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaramit dhe verifikimin e kësaj pasurie, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka qenë në shkelje të detyrimit të deklaramit, sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 për pasuritë në përdorim.
61. Këtë konkluzion, Komisioni e ka bazuar në arsyetimin se: *ky automjet i është lënë në përdorim subjektit nga shtetasi A.L, të paktën për periudhën 2010 – 2016 dhe në këto kushte, nisur nga situata faktike, përderisa ka rezultuar edhe nga policat e sigurimit se kishte të drejta përdorimi mbi këtë mjet, ai kishte detyrimin ta deklaronte këtë marrëdhënie në deklaratën “vetting”, në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, i cili, i parë në harmoni me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, e detyronte subjektin ta deklaronte këtë automjet si pasuri në përdorim të tij.*
62. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për shkelje të detyrimit të deklaramit të këtij mjete me pretendimin se nuk ka pasur detyrim për deklarimin e këtij fakti pasi përdorimi i mjetit nuk ka qenë i përhershëm, por sporadik, në raste të veçanta dhe jo pa ndërprerje. Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ai nuk ka qenë në kushtet e detyrimit për deklarim, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, pasi ai nuk ka pasur asnjë të drejtë reale lidhur me automjetin objekt kontrolli. Sipas subjektit të rivlerësimit, fakti që emri i tij figuron në policat e sigurimit të automjetit nuk do të thotë që ai ka të drejta reale mbi këtë automjet.
63. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, pasi verifikoi hetimin e kryer lidhur me kontrollin e kësaj pasurie në përdorim<sup>17</sup> dhe aktet e administruara në fashikull, nga vlerësimi i situatës faktike të evidentuar nga Komisioni në vendim, trupi gjykues vlerësoi se, me të drejtë, Komisioni ka arritur në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, me mosdeklarimin e këtij automjeti në deklaratën e pasurisë *vetting*, rezultoi të mos ketë përmbushur një detyrim kushtetues dhe ligjor për deklarimin e pasurive në përdorim, sipas parashikimit të nenit D, pika 1 e Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, vlerësuar ky në harmoni me parashikimin e pikës 11 të nenit 3 të të njëjtit ligj, ku përcaktohet koncepti i pasurisë që përbën objekt për deklarim në kontekstin e procesit të rivlerësimit kalimtar.
64. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se ai nuk ka qenë në kushtet e detyrimit për deklarim, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, pasi ai nuk ka pasur asnjë të drejtë reale lidhur me automjetin objekt kontrolli, çmohen pa efekt dhe nuk e cenojnë konkluzionin e Komisionit, sa kohë ky i fundit, konkluzionin në lidhje me këtë pasuri, e ka arritur jo në kuptim të parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar dhe objektit të deklaramit periodik vjetor sipas këtij ligji, por përkundrazi, bazuar në parashikimet përkatëse sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore që normojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, ku detyrimi për deklarim përfshin në mënyrë të shprehur edhe pasuritë në përdorim, pavarësisht se, lidhur me këto pasuri, nuk janë krijuar të drejta reale sipas Kodit Civil. Trupi gjykues vlerësoi gjithashtu se numri i rasteve kur ky automjet është përdorur nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk ndikon në analizën e kësaj çështjeje, në kushtet kur, nga hetimi administrativ, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në momentin e kryerjes së deklaramit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, ka pasur një policë të vlefshme për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve

<sup>17</sup> Shih faqet 26-29 të vendimit të Komisionit.

motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (TPL), me afat 07.07.2016 - 15.09.2017, fakt të cilin nuk e ka kundërshtuar.

65. Gjithashtu, Kolegji konstaton se, nga komunikimi i Komisionit me noteren A. O., kjo e fundit ka përcjellë pranë Komisionit, në përgjigje të shkresës së këtij të fundit, nr. {\*\*\*} prot., datë 01.07.2020, kontratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.12.2016, sipas së cilës rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur në huapërdorje automjetin objekt vlerësimi, të cilin ia kishte dhënë pronari, z. F. B.. Në përfundim të sa më sipër, konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting* të pasurisë në përdorim, *automjet të tipit "Volkswagen 3 C Passat", me targë {\*\*\*}*, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016, çmohet i bazuar në fakte dhe në ligj.
66. Lidhur me *analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2003-2016, të cilën subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi* si të gabuar lidhur me disa zëra vlerësimi, në disa vite të kësaj analize, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.
67. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me rezultatin e analizës financiare të kryer për periudhën e rivlerësimit 2003-2016, duke pretenduar se:
- 67.1. Shpenzimet minimale jetike në vitin 2005, për qytetin e Bajram Currit, janë në shumën 547.785 lekë dhe jo sa përllogaritur nga Komisioni, në shumën 657.342 lekë.
- 67.2. Në vitin 2007, nuk ka kryer asnjë pagesë për blerjen e apartamentit në Tiranë dhe, rrjedhimisht, ky shpenzim është përfshirë pa të drejtë në analizën financiare të këtij viti. Subjekti pretendon se këtë vit e ka mbyllur me një balancë pozitive dhe me gjendje *cash* në fund të vitit prej 1.815.100 lekësh.
- 67.3. Në vitin 2009, nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni të ardhurat nga paga e bashkëshortes, në shumën 600.000 lekë, të cilat janë të ardhura të ligjshme, pasi ka qenë detyrimi i punëdhënësit për të paguar sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat.
- 67.4. Në vitin 2010, nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni: (i) gjendja *cash* prej 400.000 lekësh, në fillim të vitit; (ii) shuma prej 600.000 lekësh, të ardhura nga paga e bashkëshortes; si dhe (iii) shpenzimet minimale jetike duhen përllogaritur në shumën 683.100 lekë.
- 67.5. Në vitin 2012, nuk është marrë parasysh gjendja në llogarinë e bashkëshortes në Raiffeisen Bank, në shumën 211.329 lekë, në fillim të vitit, si dhe shpenzimet minimale jetike për këtë vit sipas subjektit duhen përllogaritur në shumën 683.100 lekë. Gjithashtu, për këtë vit, subjekti pretendoi se shpenzimet e udhëtimit jashtë shtetit nuk janë përllogaritur në mënyrë analitike dhe nuk i është kaluar barrë prove për to. Këto shpenzime kanë qenë në shumën 2.150 euro, për të cilat dhe ka paraqitur në Komision një kopje të dokumentit të rezervimit nga kompania "{\*\*\*}", për këtë udhëtim, me destinacion Turqinë, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në Bruksel janë paguar nga motra e tij D. D..
- 67.6. Në vitin 2013 dhe 2014, shpenzimet minimale jetike duhen përllogaritur në shumën 1.101.900 lekë. Subjekti, në tërësi, për shpenzimet e jetesës, pretendoi se vlerat e treguesve sipas INSTAT-it janë orientuese, por jo domosdoshmërisht të vërteta, pasi në varësi të ekonomisë familjare këto shpenzime mund të jenë më të pakta, të tilla si shpenzimet për pije alkoolike, duhan

apo qira, si dhe kursimi mund të jetë më i lartë, nga mënyra e menaxhimit të ekonomisë familjare. Shpenzimet për pije alkoolike, duhan apo qira, sipas subjektit, nuk kanë qenë të nevojshme, për rrjedhojë nuk duhen përlllogaritur. Sipas subjektit, përlllogaritjet e Komisionit për këto shpenzime janë më të larta se shpenzimet referuar statistikave të INSTAT-it, dhe se nuk ka akt ligjor apo administrativ të bërë publik, ku përcaktohet se sa duhet të jenë shpenzimet minimale mujore për një familje me 6 anëtarë, dhe se subjekti ka paraqitur në Komision anketën e buxhetit të familjes, marrë nga faqja zyrtare e INSTAT-it. Sipas Bankës Botërore në Republikën e Shqipërisë, më shumë se 40% e popullsisë jeton me më pak se 5 USD në ditë dhe rreth 20% e saj jeton me më pak se 2 USD në ditë, pra, sipas subjektit, nuk ka arsye që të pretendohet se familja e një gjyqtari nuk mund të jetojë me më pak shpenzime se ato të përlllogaritura nga INSTAT-i ose Komisioni.

68. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, pas verifikimit të akteve të fashikullit, si dhe kontrollit të ushtruar nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor analizës financiare të kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si më poshtë:
69. Fillimisht, sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e gabuar nga ana e Komisionit në analizën financiare të vitit 2007 të pagesës së kryer për blerjen e apartamentit, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim ka gjetur trajtim të zgjeruar në analizën e kryer më sipër në vendim<sup>18</sup> lidhur me pasurinë e paluajtshme “*apartment banimi*” me sip. 158 m<sup>2</sup>, me vlerë 60.000 euro dhe vendndodhje në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë dhe, për rrjedhojë, çmohet i panevojshëm shqyrtimi i këtij pretendimi në drejtim të shkakut të ankimit mbi rezultatin e gabuar të analizës financiare për vitin 2007.
70. Lidhur me pretendimet mbi përlllogaritjen e gabuar të shpenzimeve të jetesës për vitet 2005, 2010, 2012, 2013 dhe 2014, trupi gjykues vëren se Komisioni ka arsyetuar lidhur me këtë çështje në vendim se: *pretendimet lidhur me reduktimin e shpenzimeve jetike vlerësohen se janë të karakterit deklarativ dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk do të reflektojë ndryshime në analizën financiare sa i përket këtij zëri.*
71. Nga verifikimi i kryer në Kolegj i përlllogaritjeve të Komisionit për vitet e sipërcituara, ato rezultojnë të jenë në përputhje me të dhënat e “*Konsumit ushqimor për frymë dhe për familje sipas shkresës së ILDKPKI-së, datë 04.03.19, referuar të dhënave të INSTAT-it ndër vite*” dhe, rrjedhimisht, shpenzimet e jetesës vlerësohen të jenë përlllogaritur në mënyrë të saktë në vitet e marra në shqyrtim 2005, 2010, 2012, 2013 dhe 2014. Trupi gjykues thekson se shpenzimet e jetesës që përdoren nga institucionet e rivlerësimit në funksion të analizës financiare për subjektet e rivlerësimit, sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, janë vlera mesatare dhe përfshijnë të gjitha shtresat e popullsisë dhe zonat e Shqipërisë, që do të thotë se ato nuk mund të përfaqësojnë shpenzimet reale të çdo individi dhe familjeje. Në këtë kuptim, ato përbëjnë një vlerë mesatare që përfaqëson një jetesë normale të një njësie familjare dhe jo shpenzime që realisht janë kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, pasi shpenzimet mujore të përdorura si referencë përfshijnë të dhëna nga anketimet për konsumin mujor mesatar të kryer nga familjet me nivele të ndryshme të ardhurash, duke standardizuar dhe unifikuar këto shpenzime.
72. Sa i takon pretendimit të subjektit për zbritjen e zërave të shpenzimeve për pije alkoolike, duhan apo qira, si pjesë përbërëse e shpenzimeve jetike, vlerësohet se vlera mesatare e këtyre shpenzimeve jetike sipas INSTAT-it përfshin në anketën e përzgjedhjes të gjitha llojet e familjeve, si ato që konsumojnë duhan dhe alkool apo që kanë shpenzime qiraje, ashtu dhe ato familje që nuk

<sup>18</sup> Shih paragrafin 27 e në vijim të këtij vendimi.

konsumojnë apo kryejnë këto zëra shpenzimesh, duke përfshirë një vlerë të mesatarizuar të këtyre shpenzimeve jetike për çdo vit, për rrjedhojë pretendimi i subjektit nuk mund të merret në konsideratë.

73. Lidhur me pretendimin e subjektit për mosmarrjen në konsideratë në përlllogaritje nga ana e Komisionit të të ardhurave nga paga e bashkëshortes, si e punësuar pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, në shumën 600.000 lekë, për vitet 2009 dhe 2010, të cilat pretendohen si të ardhura të ligjshme, trupi gjykues, pasi ka kontrolluar analizën e kryer nga Komisioni, ka konstatuar se ky i fundit, në analizën financiare për periudhën 2003-2016, rezulton se ka marrë në konsideratë në përlllogaritje të ardhura nga paga e bashkëshortes, si e punësuar pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, për vitin 2010, në shumën prej 450.000 lekësh, ndërsa për vitin 2009 të ardhurat e pretenduara nga paga prej 600.000 lekësh nuk janë marrë në konsideratë.
74. Trupi gjykues vëren se Komisioni ka arsyetuar në vendimin objekt ankimi se nga *analiza e provave të depozituara nga subjekti, konfirmohet se personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit) ka qenë në marrëdhënie punësimi që prej majit të vitit 2010, në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, por, nuk dokumentohet punësimi i kësaj shtetaseje për periudhën nga viti 2009 – prill të vitit 2010. Komisioni gjithashtu ka arsyetuar se duke qenë se punëdhënësi ka detyrimin dhe përgjegjësinë për pagimin e tatimit dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punëmarrësit, vlerat e të ardhurave neto nga paga do merret sipas kreditimeve mujore në llogarinë bankare të personit të lidhur.*
75. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të çështjes, trupi gjykues vëren se, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga paga e bashkëshortes të përfituar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA, në shumën prej 600.000 lekësh, ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga paga e bashkëshortes të përfituar nga e njëjta shoqëri, në shumën prej 720.000 lekësh.
76. Nga aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e akteve justifikuese konstatohet se në dokumentin “Vërtetim për bazën e vlerësuar”, datë 19.07.2021, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier, referohen të dhëna të punësimit të bashkëshortes së subjektit në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, në Fier, për periudhën maj 2010 - dhjetor 2011. Në këtë dokument specifikohet se për periudhën 01.01.2009 - 31.12.2009 nuk disponohen listëpagesa, dhe se për periudhën 01.01.2010 - 30.04.2010 nuk figuron emri i personit të lidhur.
77. Gjithashtu, nga verifikimi i kryer rezultoi se të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes së subjektit pranë këtij subjekti janë përlllogaritur nga Komisioni sipas kreditimeve mujore në llogarinë bankare të saj në Raiffeisen Bank ShA, referuar lëvizjeve të kësaj llogarie të paraqitur nga vetë subjekti në përgjigjet ndaj rezultateve të hetimit, në të cilën të dhënat bankare fillojnë nga data 05.05.2010 dhe jo më parë dhe se gjatë këtij viti janë kryer gjithsej 9 kreditime në favor të bashkëshortes së subjektit, në shumën totale prej 450.000 lekësh (9 muaj x 50.000 lekë = 450.000 lekë).
78. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në aktet e fashikullit të çështjes qëndrimin e Komisionit për përlllogaritjen e pagave të bashkëshortes si e punësuar pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, në shumën 450.000 lekë për vitin 2010 dhe mospërlllogaritjen e tyre për vitin 2009, për sa kohë që, për periudhën para datës 05.05.2010, nuk u arrit të provohet as punësimi pranë kësaj shoqërie, as përfitimi i të ardhurave prej saj.

79. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në vitin 2012 nuk është marrë në konsideratë gjendja në fillim të vitit në llogarinë e bashkëshortes në Raiffeisen Bank, në shumën 211.329 lekë, trupi gjykues, pasi kreu verifikimet e nevojshme nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, arriti në përfundimin se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk është i bazuar në fakte. Ky konkluzion vjen si rrjedhojë e konstatimit se në llogarinë e pagës pranë Raiffeisen Bank ShA, bashkëshortja e subjektit ka pasur gjendje likuiditetesh, në datën 31.12.2011, në shumën 211.329 lekë, e cila është pakësuar gjatë vitit 2012 me vetëm 101.488 lekë, dhe se Komisioni e ka përlllogaritur saktë pakësimin e këtyre likuiditeteve në bankë në shumën e sipërcituar, në analizën e vitit 2012, e cila ka shërbyer si e hyrë në ekonominë familjare për këtë vit.
80. Sa i takon zërit të *shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit gjatë vitit 2012*, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ato nuk janë përlllogaritur në mënyrë analitike dhe se Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove lidhur me to. Këto shpenzime, sipas subjektit, kanë qenë në shumën 2.150 euro dhe se në mbështetje të këtij pretendimi ai ka paraqitur në Komision një kopje të dokumentit të rezervimit nga kompania “{\*\*\*}”, për këtë udhëtim në Turqi, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimin në Bruksel janë paguar nga motra e tij D. D..
81. Në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi, nga verifikimi i akteve në fashikull, konstatohet se, si me të drejtë pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk ka paraqitur përlllogaritjet e kryera lidhur me kostot e udhëtimeve jashtë vendit nga subjekti dhe familja e tij, në vitin 2012, në mënyrë analitike.
82. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të çështjes, konstatohet se shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit për vitin 2012 janë përlllogaritur nga Komisioni, në shumën totale prej 388.422 lekësh, referuar tabelës së analizës financiare përmbledhëse për periudhën e rivlerësimit 2003-2016 në dokumentin e rezultateve të hetimit, me të cilën subjektit të rivlerësimit rezultoi t’i ketë kaluar nga Komisioni barra e provës për rezultatin negativ financiar të këtij viti prej 1.059.219 lekësh. Në përfundim, pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit ndaj rezultateve të hetimit, shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit për këtë vit, sipas tabelës së analizës financiare të paraqitur në vendimin objekt ankimi, janë përlllogaritur në shumën prej 356.286 lekësh.
83. Nga verifikimet e kryera në Kolegj, referuar të dhënave të sistemit TIMS, konstatohet se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë kryer gjatë vitit 2012 këto udhëtime: (i) udhëtimin me destinacionin Antalia, në datat 01.08.2012 - 12.08.2012 (gjithë familja); (ii) udhëtimin me destinacionin Bruksel, Belgjikë, në datat 20-23 dhjetor 2012 (vetëm subjekti); dhe (iii) udhëtimin me destinacionin Selanik, Greqi, në datat 26-28 maj 2012 (vetëm subjekti).
84. Trupi gjykues vëren se, ndonëse Komisioni nuk ka dhënë qartësi për subjektin në drejtim të përlllogaritjeve të kryera dhe individualizimin e shpenzimeve për secilin udhëtim, nuk ka munguar të bëjë transparencë në drejtim të mënyrës së përlllogaritjes së këtij zëri shpenzimesh, i cili, referuar “Aneksit 1 (Metodologjia) për subjektin Izet Dushaj, shpjegime për analizën përmbledhëse financiare”, thuhet të jetë përlllogaritur *mbi bazë të dokumentacionit ligjor të disponuar, deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe referuar metodologjisë së aplikuar nga KPA-ja (vendimi nr. 11 (JR), datë 22.05.2019)*. Në këto kushte, trupi gjykues, në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit për përlllogaritje të gabuar nga Komisioni të shpenzimeve të udhëtimit jashtë shtetit për këtë vit, përlllogariti sipas metodologjisë së përcaktuar nga Kolegji në vendimin orientues nr. 11 (JR), datë 22.05.2019, shpenzimet e kryera, nga ku rezultoi se: (i) për udhëtimin në “Antalia”, shpenzimet janë në shumën e paketës turistike prej 2.150 eurosh, sipas dokumentacionit përkatës justifikues; (ii) për udhëtimin e subjektit me destinacion Brukselin, u

përlllogaritën vetëm kostot e biletës së avionit me linjën “Lufthansa”<sup>19</sup>, sipas standardit të aplikuar nga Kolegji në shumën prej 180 eurosh, ndërsa shpenzimet e qëndrimit u përlllogaritën me kosto 5 euro/ditë (referuar deklaramit të vetë subjektit se ka qëndruar te motra e tij, znj. D. D.); (iii) për udhëtimin e subjektit të rivlerësimit në Selanik, u përlllogaritën shpenzime qëndrimi për 2 net, në shumën 100 euro, si dhe shpenzime transporti për udhëtimin me automjet sipas itinerarit Tiranë-Kapshticë-Selanik, në shumën 81 euro, në total 181 euro. Në total, shpenzimet e përlllogaritura nga Kolegji, për udhëtimet jashtë shtetit gjatë vitit 2012, kapin vlerën e 2.511 eurove ose shumën prej 352.922 lekësh<sup>20</sup>.

85. Në përfundim të shqyrtimit të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se shuma e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit për vitin 2012, e përlllogaritur nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, prej 352.922 lekësh, është e përafërt me shumën totale të shpenzimeve të këtij zëri, të përlllogaritura nga Komisioni, prej 356.286 lekësh, me një diferencë të papërfillshme prej vetëm 3.364 lekësh. Për pasojë, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në fakte përlllogaritjen nga Komisioni të zërit të *shpenzimeve të udhëtimeve jashtë shtetit* të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij për vitin 2012.
86. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit për periudhën e vlerësimit 2003-2016, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan me mungesë të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në vitet 2005, 2007, 2009, 2010, 2012, 2013 dhe 2014, respektivisht në shumat (-) 68.179 lekë, (-) 8.274.007 lekë, (-) 133.324 lekë, (-) 449.057 lekë, (-) 632.143 lekë, (-) 33.364 lekë dhe (-) 31.448 lekë. Në total, mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve në periudhën e rivlerësimit 2003-2016 është në shumën e (-) 9.621.522 lekëve.
87. Në variantin e një analize garantiste për subjektin e rivlerësimit, sipas trajtimit të mësipërm në shqyrtimin e shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, analiza financiare për periudhën 2003-2016 do të paraqitej me mungesë të të ardhurave të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në vitin 2005, në shumën e (-) 68.179 lekëve, në vitin 2007, në shumën e (-) 1.019.407 lekëve, në vitin 2008, në shumën e (-) 96.215 lekëve, në vitin 2009, në shumën e (-) 133.324 lekëve, në vitin 2010, në shumën e (-) 449.057 lekëve, në vitin 2012, në shumën e (-) 632.143 lekëve, në vitin 2013, në shumën e (-) 33.364 lekëve dhe në vitin 2014, në shumën e (-) 31.448 lekëve, në total me një mungesë burimesh të ligjshme në shumën e (-) 2.463.137 lekëve. Kjo mungesë burimesh të ligjshme financiare konstatohet të jetë më e lartë se pragu i aplikuar nga jurisprudenca e Kolegjit, sipas parimit të proporcionalitetit, në caktimin e masës disiplinore në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
88. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 33, pika 5, shkronjat “a” e “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për pasojë, duhet të lihet në fuqi.

<sup>19</sup> Sipas të dhënave në sistemin TIMS.

<sup>20</sup> Konvertuar me kursin mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë, për vitin 2012.

## **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 451, datë 23.09.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Izet Dushaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 17.02.2025, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*